KARTA E OTAVËS PËR PROMOVIMIN E SHËNDETIT

Isme Humolli

Shefe e Zyrës së OBSH-së në Kosovë

Specialist i Epidemiologjisë

Korrespodenca:
humollii@who.int

Karta e Otavës për Promovimin e Shëndetit është marrëveshje ndërkombëtare historike e miratuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) më 21 nëntor 1986 që kishte synimin kryesor "Shëndet për të gjithë".

Qëllimi kryesor i Kartës së Otavës për Promovimin e Shëndetit është të ofrojë një kornizë globale që u mundëson njerëzve të rrisin kontrollin mbi shëndetin e tyre dhe ta përmirësojnë atë.

Karta e Otavës u mbështet në suksesin dhe përparimin e arritur në shëndetësinë globale përmes Deklaratës së Alma-Ata-së për Kujdesin Parësor Shëndetësor (KPSh), strategji e Organizatës Botërore të Shëndetësisë e përqafuar nga të gjitha shtetet anëtare mbi objektivat "Shëndet për të gjithë". Edhe pas shumë viteve të miratimit, Karta e Otavës mbetet jashtëzakonisht e rëndësishme si kornizë themelore për shëndetin publik global për të cilën u diskutua dhe është shqyrtuar në debatin e fundit të Asamblesë Botërore të Shëndetësisë mbi rëndësinë dhe domosdoshmërinë e veprimit ndërsektorial për të arritur deri tek qëllimi "Shëndet për të gjithë".

OBSh definon qartë, individi për të pasur shëndet të plotë duhet të plotësohen kushtet themelore të nevojshme:

•Të jetojë në paqe dhe ketë strehim.

•Të jetë i arsimuar, të ketë ushqim dhe të ardhura.

•Të jetojë në ekosistem të qëndrueshëm dhe të ketë burime të shfrytëzueshme në vazhdimësi.

•Të ketë drejtësi sociale dhe barazi.

Karta e Otavës ka definuar pesë strategji kryesore të veprimit për promovimin e shëndetit: 1. Zhvillimi i politikave të shëndetshme 2. Krijimi i mjediseve përkrahëse 3. Forcimi i rolit dhe angazhimit të komunitetit 4. Zhvillimi i aftësive personale dhe 5. Riorientimi i shërbimeve shëndetësore.

Strategjitë e definuara kanë për qëllim që shërbimet shëndetësore të jenë më afër komunitetit dhe të ndërveprojnë së bashku.

Rëndësi e veçantë dhe pikë e ndritshme është promovimi dhe edukimi shëndetësor i popullatës duke shfrytëzuar mjete dhe platforma të ndryshme. Kjo drejtpërdrejtë ndikon në zhvillimin e aftësive personale të individit për t'u kujdesur për shëndetin e vetë dhe për të pasur një jetë të gjatë dhe cilësore.

Zhvillimi i aftësive personale është një nga pesë strategjitë e Kartës së Otavës që përkrahë zhvillimin personal dhe shoqëror përmes ofrimit të informatës, edukimit shëndetësor dhe përmirësimit të aftësive jetësore. Ku qëllimi kryesor është të rrisë mundësitë në dispozicion të njerëzve, në mënyrë që ata të mund të ushtrojnë kontroll më të madh mbi shëndetin dhe mjedisin e tyre.

Tërë kjo mund të realizohet përmes mekanizmave esencial që nuk kushtojnë shumë, por përfitimet janë të mëdha:

•Të mësuarit gjatë gjithë jetës: ndihmon individët të përgatiten për të gjitha fazat e jetës.

•Mekanizmat për përballimin e vështirësive: mundësojnë që individët të fitojnë aftësi për të menaxhuar sëmundjet kronike, lëndimet dhe faktorët stresues të përditshëm.

•Ndërveprimi në mjedise të ndryshme: arrihet përmes shkollave, shtëpive, vendeve të punës dhe komuniteteve lokale.

•Nërveprimi bashkëpunues dhe ndërinstitucional: përfshin institucione arsimore, profesionale, tregtare dhe organizata vullnetare.

Strategji tjetër e Kartës së Otavës është riorientimi i shërbimeve shëndetësore që nënkupton zhvendosjen e fokusit të sistemit shëndetësor nga trajtimi i sëmundjeve drejt parandalimit aktiv të tyre dhe promovimit të shëndetit të përgjithshëm.

Qëllimet kryesore të riorientimit të shërbimeve shëndetësore

•Balancimi i parandalimit dhe trajtimit: të orientohen investimet dhe burimet në mënyrë që parandalimi i sëmundjeve dhe promovimi i shëndetit të kenë rëndësi dhe vend të veçantë krahasuar me shërbimet tradicionale shëruese.

•Zgjerimi i mandatit: ku tejkalohet fokusi i ngushtë klinik i institucioneve shëndetësore dhe adresohen nevojat kulturore, sociale, ekonomike dhe mjedisore.

•Ndarja e përgjegjësisë: nxitet bashkëpunimi ndërmjet individëve, grupeve të komunitetit, profesionistëve shëndetësorë dhe qeverive për të mbështetur mënyra më të shëndetshme jetese.

•Fokusimi në shëndetin e popullatës: suksesi matet përmes rezultateve të përgjithshme shëndetësore të komunitetit krahas shërimit të pacientëve individualë.

•Përditësimi i trajnimit dhe kërkimit shkencor: të ndryshohet edukimi profesional në mënyrë që të zhvillohen qëndrime dhe aftësi të përqendruara në mirëqenien e përgjithshme dhe jo vetëm në menaxhimin e sëmundjeve.

Kosova ka bërë përparime të dukshme në politikëbërje në përgjithësi dhe fuqizimin e Mjekësisë Familjare në veçanti si vijë e parë e frontit në sistemin shëndetësor duke qenë më afër popullatës. Kjo mundëson që Mjekësia Familjare të përmbushë mandatin që ka: promovimin dhe edukimin shëndetësor të popullatës për jetë të shëndetshme dhe cilësore. Me këtë do të ngriten aftësitë e individit për ruajtjen e shëndetit dhe riorientimin e sistemit shëndetësor drejt baraspeshës parandalimit dhe mjekimit, atëherë indikatorët shëndetësor do jenë mjaft pozitiv.